



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC
DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE JURIDIKE DHE ARKIVIT

Roskovec, më 13.11.2025

**SHPALLJE PËR LËVIZJE PARALELE
DHE PRANIM NË SHËRBIMIN CIVIL**

SPECIALIST PËR MENAXHIMIN E BURIMEVE NJEREZORE

Ne zbatim të nenit 22 dhe 25 të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, si dhe kreut II, III, IV dhe V, të Vendimit nr.243 date 18.03.2015 të Keshillit të Ministrave “Për pranimin, levizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive”, Bashkia Roskovec shpall Procedurat e lëvizjes paralele dhe e pranimin në shërbimin civil për pozicionin:

Dy vende pune në pozicionin **Specialist për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore** në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore, Juridike dhe Arkivit

- Kategoria e pagës IV-3.

Pozicioni i më sipër, u ofrohen fillimisht nëpunësve civilë të së njëjtës kategori për procedurën e lëvizjes paralele! Vetëm në rast se ky pozicion, në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton ende vakant, ai është të vlefshme për konkurrimin nëpërmjet procedurës së pranimin në Shërbimin Civil

Për të dy Procedurat (lëvizje paralele dhe pranimin në shërbimin civil) aplikohet në të njëjtën kohë!

Afati për dorëzimin e dokumentave për:

LËVIZJE PARALELE

22/11/2025

Afati për dorëzimin e dokumentave për:

PRANIM NË SHËRBIMIN CIVIL

27/11/2025

• **Përshkrimi përgjithësues i punës për pozicionin Specialist për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore :**

- Të ndjekë dhe evidentojë me shkrim zbatimin e orarit të punës, prezencën e personelit në punë nëdrejtoritë dhe sektorët e bashkisë, si dhe në institucionet varëse;
- Të hartojë planin e lejeve të zakonshme për vitin pasardhës dhe ndjekë zbatimin e tij pas miratimit nga Kryetari i Bashkisë;
- T'i japë sektorit të financës të dhënat e nevojshme për pagat, klasat, vjetërsinë në punë, masën e shpërblimit për funksionin, shkallën e vështirësisë në punë etj;
- Kërkon nga personeli i Bashkisë zbatimin e rregullores së administratës, akteve ligjore dhe nënligjore për disiplinën në punë të nëpunësit civil dhe vendimet e udhëzimet e Kryetarit të Bashkisë;
- Administron regjistrin themeltar të personelit dhe punonjësve të bashkisë, me të gjitha të dhënat përkatëse dhe bën azhurnimin sipas rastit;
- Ruan, sistemon dhe administron librezat e punës së punonjësve që janë ose merren në punë në bashki, duke bërë sistemimin e tyre sipas regjistrit themeltar;
- Ndjek në dinamikë pasurimin e dosjeve të personelit, duke bërë në to ndryshimet përkatëse, në bazë të urdhrave dhe vendimeve për lëvizje, dhënie stimuljesh, masa disiplinore, mbarim shkolle dhe kurse, duke vendosur në pjesën përkatëse vlerësimet periodike të punës së nëpunësit;
- Mban në çdo rast protokollin e mbledhjeve që bëhen në administratë, duke sekretuar protokollin përkatës dhe duke e dorëzuar në arkivin e bashkisë në fund të vitit.

I-Lëvizja paralele

Kanë të drejtë të aplikojnë për këtë procedurë vetëm nëpunësit civilë të së njëjtës kategori, në të gjitha institucionet pjesë e shërbimit civil.

1.1 KUSHTET PËR LËVIZJEN PARALELE DHE KRITERET E VEÇANTA

Kushtet që duhet të plotësojë kandidati në procedurën e lëvizjes paralele janë:

- Të jenë nëpunës civil të konfirmuar, brenda së njëjtës kategori,
- Të mos kenë masë disiplinore në fuqi (të vërtetuar me një dokument nga institucioni);
- Të kenë të paktën vlerësimin e fundit “Mirë” apo “Shumë mirë”;

Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si vijon:

- a) Te zoteroje një Diplomë “Bachelor” në shkencat sociale/juridike/ekonomike apo fusha të ngjashme me to.. *(Diplomat të cilat janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë të njohura paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njehsimin e diplomave sipas legjislacionit në fuqi).*
- b) Të kenë eksperiencë pune mbi 1 vit.
- c) Të kenë aftësi të mira komunikuese dhe të punës në grup.
- d) Te ketë njohuri të një gjuhe të huaj.

1.2 DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidati duhet të dërgojë dorazi në një zarf të mbyllur, në zyrën e Drejtorisë së Burimeve Njerëzore, Juridike dhe Arkivit të Bashkisë Roskovec, këto dokumenta:

- Letër motivimi për aplikim në vendin vakant.
- Një kopje të jetëshkrimit.
- Një numër kontakti dhe adresën e plotë të vendbanimit.
- Fotokopje e diplomës. Nëse aplikanti disponon një diplomë të një universiteti të huaj duhet ta ketë të njesuar pranë Ministrisë së Arsimit.
- Fotokopje e listës së notave. Nëse ka një diplomë dhe listë notash të ndryshme me vlerësimin e njohur në Shtetin Shqiptar, aplikanti duhet ta ketë të konvertuar atë sipas sistemit shqiptar.
- Fotokopje të një vlerësimi vjetor.
- Fotokopje të aktit të konfirmimit të Statusit të nëpunësit civil.
- Fotokopje të librezës së punës e plotësuar.
- Çertifikata ose dëshmi të kualifikimeve, trajnimeve të ndryshme.
- Fotokopje e letërnjoftimit.
- Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore
- Vërtetim gjendjes shëndetsore;

Dokumentet duhet të dorëzohen në institucion, brenda datës 22.11.2025.

1.3 REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK

Në datën **25.11.2025**, Drejtoria e Burimeve Njerëzore, Juridike dhe Arkivit në Bashkisë Roskovec do të shpallë në portalin “Drejtoria e Burimeve Njerëzore, Juridike dhe Arkivit në Bashkisë Roskovec”, në faqen zyrtare të internetit të Bashkisë dhe në stendin e informimit të publikut listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kriteret e veçanta.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kriteret e veçanta do të njoftohen individualisht nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore, Juridike dhe Arkivit të Bashkisë Roskovec, nëpërmjet adresës tuaj të e-mail, për shkaqet e moskualifikimit.

Kandidatët, të cilët rezultojnë të pakualifikuar, brenda 3 (tri) ditëve kalendarike nga data e njoftimit individual, paraqesin ankesat me shkrim pranë Drejtorsë së Burimeve Njerëzore, Juridike dhe Arkivit të Bashkisë Roskovec. Ankesat zgjidhen brenda 5 (pesë) ditëve kalendarike, nga data e paraqitjes së tyre.

1.4 FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET INTERVISTA

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

- a. Ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjes vendore”
- b. Ligjin nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”
- c. Ligjin nr. 9367 date 07.04.2005 “Per parandalimin e konfliktit te interesave”.

- d. Ligjin nr. 9131 dt. 08.09.2003 “Për rregullat e Etikës në Administratën Publike”
- e. Ligjin nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”
- f. Ligjin nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”

1.5 MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me dokumentacionin e dorëzuar:

Kandidatët do të vlerësohen për përvojën, trajnimet apo kualifikimet e lidhura me fushën, si dhe certifikimin pozitiv. Totali i pikëve për këtë vlerësim është 40 pikë, i ndarë në: 20 pikë përvojë, 10 pikë për trajnime apo kualifikime të lidhura me fushën përkatëse dhe 10 pikë për certifikimin pozitiv ose për vlerësimet e rezultateve individuale në punë, në rastet kur procesi i certifikimit nuk është kryer

Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohet me 60 pikë.

Totali i pikëve është 100 pikë.

1.6

DATA E KONKURIMIT DHE DALJA E REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT

Për datën dhe vendin e konkurimit kandidatët do të njoftohen nga Drejtoria e Burimeve Njerezore, Juridike dhe Arkivit

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Bashkia Roskovec do të shpallë fituesin në Faqen Zyrtare të Bashkisë Roskovec dhe në portalin “Drejtorisë Rajonale të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive”. Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen në mënyrë elektronike për datën e saktë të shpalljes së fituesit.

2- Pranimi në Shërbimin Civil

Vetëm në rast se pozicioni i publikuar në këtë shpallje, në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton ende vakant, ky pozicion do të jetë i vlefshëm për konkurim nëpërmjet procedurës së pranim në shërbimin civil.

Për këtë procedurë kanë të drejtë të aplikojnë të gjithë personat që janë jashtë shërbimit civil.

2.1

KUSHTET QË DUHET TË PLOTËSOJË KANDIDATI NË PROCEDURËN E PRANIMIT NË SHËRBBIMIN CIVIL

Kushtet që duhet të plotësojë kandidati në procedurën e Pranimi në Shërbimin Civil:

- a. Te jete shtetas shqiptar;
- b. Te kete zotesi te plote per te vepruar;
- c. Te zoteroje gjuhen shqipe, te shkruar dhe te folur;

- d. Te jete ne kushte shendetesore qe e lejojne te kryeje detyren perkatese;
- e. Te mos jete i denuar me vendim te formes se prere per kryerjen e nje krimi apo per kryerjen e nje kundervajtjeje penale me dashje;
- f. Ndaj tij te mos jete marre masa disiplinore e largimit nga sherbimi civil, qe nuk eshte shuar sipas ligjit nr. 152/2013.

Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si vijon:

- a) te zoteroje nje Diplomë “Bachelor” në shkencat sociale/juridike/ekonomike apo fusha të ngjashme me to. *(Diplomat të cilat janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë të njohura paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njehsimin e diplomave sipas legjislacionit në fuqi).*
- b) Të kenë eksperiencë pune deri në 1 vit.
- c) Të kenë aftësi të mira komunikuese dhe të punës në grup.
- d) Te kete njohuri te një gjuhe te huaj.

2.2 DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentet si më poshtë:

- a- Jetëshkrim;
- b- Fotokopje të diplomës (përfshirë edhe diplomën bachelor);
- c- Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- d- Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimim shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj;
- e- Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- f- Vërtetim të gjëndjes shëndetësore;
- g- Vetëdeklarim të gjëndjes gjyqësore.

Dokumentet duhet të dorëzohen në institucionin e Bashkisë Roskovec, brenda datës 27.11.2025

2.3 REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK

Në datën **05.12.2025**, Drejtoria e Burimeve Njerëzore, Juridike dhe Arkivit të Bashkisë Roskovec do të shpallë në portalin “Drejtorisë Rajonale të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive”, në faqen zyrtare të internetit të Bashkisë dhe ne stenden e informimit të publikut listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kriteret e veçanta.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kriteret e veçanta do të njoftohen individualisht nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore, Juridike dhe Arkivit të Bashkisë Roskovec, nëpërmjet adresës tuaj të e-mail, për shkaqet e moskualifikimit.

Kandidatët, të cilët rezultojnë të pakualifikuar, brenda 5 (pesë) ditëve kalendarike, nga data e njoftimit individua, paraqesin ankesat me shkrim pranë Drejtorsë së Burimeve Njerëzore, Juridike dhe Arkivit të Bashkisë Roskovec. Ankesat zgjidhen brenda 5 (pesë) ditëve kalendarike, nga data e depozitimit të ankesës.

2.4 FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET TESTIMI

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

- a. Ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjes vendore”
- b. Ligjin nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”
- c. Ligjin nr. 9367 date 07.04.2005 “Per parandalimin e konfliktit te intereresave”.
- d. Ligjin nr. 9131 dt. 08.09.2003 “Për rregullat e Etikës në Administratën Publike”
- e. Ligjin nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”
- f. Ligjin nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”

2.5 MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

Kandidatët do të vlerësohen nga Komiteti i Përhershëm i Pranimit, i ngritur pranë Bashkisë Roskovec.

Totali i pikeve te vleresimit te kandidateve eshte 100 pike te cilat ndahen perkatesisht:

- a. 15 pike për dokumentacionin e dorëzuar;
- b. 25 pikë për intervistën e strukturuar me gojë;
- c. 60 pikë për vlerësimin me shkrim.

2.6 DATA E KONKURIMIT DHE DALJA E REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Drejtoria e Burimeve Njërëzore, Juridike dhe Arkivit e Bashkisë Roskovec do të njoftojë ata individualisht në mënyrë elektronike për rezultatet (nëpërmjet adresës së e-mail). Drejtoria e Burimeve Njërëzore, Juridike dhe Arkivit do të shpallë fituesin në faqen zyrtare dhe në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”.

Të gjithë kandidatët që aplikojnë për procedurën e ngritjes në detyrë, do të marrin informacion në faqen e Bashkisë Roskovec, për fazat e mëtejshme të kësaj procedure:

- për datën e daljes së rezultateve të verifikimit paraprak;
- datën, vendin dhe orën ku do të zhvillohet konkurimi;

Për të marrë këtë informacion, kandidatët duhet të vizitojnë në mënyrë të vazhdueshme faqen e Bashkisë Roskovec duke filluar nga data: 05/12/2025

DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE JURIDIKE DHE ARKIVIT

BASHKIA ROSKOVEC